



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 30

Datë: 14. 11. 2023. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Mufera Shinik, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj.

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**
- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së KQZ-së nr.29**
- 3. Aktivitetet e Zyrës**

- 1.Monitorimi i Kuvendit Zgjedhor të partisë politike SRPSKA LISTA;
- 2.Takim me zëvendës presidentin e International Republican Institute (IRI);
- 3.Takim me përfaqësues të Komisionit të Pavarur për Media në Republikën e Kosovës;
- 4.Njoftim për procesin e auditimit të raporteve financiare të subjekteve politike për vitin 2021.

4. Raportet e Këshillave të KQZ-së

3.1.Këshilli për Operacione Zgjedhore

1. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të Realizimit të Planit të Punës së KQZ-së, për periudhën Janar – Shtator

2. *Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për projektin “Informimi dhe Edukimi i Votuesve të Rinj për Zgjedhje”*

3. *Shqyrtimi dhe miratimi i Analizës gjinore dhe e moshës e lidërsipit të partive politike për periudhën 2022-2023*

3.2.Këshilli për Buxhet dhe Financa

1. *Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit Financiar për periudhën janar-shtator 2023.*

2. *Raporti i kontratave të nënshkruara për periudhën janar – shtator 2023*

3. *Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të derivateve për periudhën janar-shtator 2023.*

4. *Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit për pasuri jo financiare të KQZ-së.*

5. Të ndryshme

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

Fillimisht, kryetari Radoniqi prezantoi një agjendë të gjatë të mbledhjes, ndërsa që pyeti anëtarët nëse kanë diçka lidhur me agjendën!

Alban Krasniqi, tha se, ka dy çështje të cilat, nuk ka kuptim që të shqyrtohen dy herë. Sekretariati, duhet me na raportue dhe kjo, është çështja e raportit të punës – zbatimi i planit të punës janar – shtator, duhet me na raportue menaxhmenti, e njëjta vlejné edhe për buxhetin, po edhe të tjerat si KOZ, prandaj, edhe të raportojné edhe menaxhertë e atyre projekteve mund të na raportojné. Pra, të raportohet prej tyre dhe të mos na raportojné këshillat.

Sekretariati, në këtë rast, aktivitetet, propozimet, projektet etj., të na prezantohen. Kjo le të jetë si praktikë, menaxhmenti i Sekretariatit ta merr përsipër dhe ta prezantojné këtu, pa e mohuar rolin e këshillave...

Sami Kurteshi, tha se në të ndryshme, propozoj të hyjë një pikë si “Njoftim” që, vjen si rezultat i takimit që kemi pasur. Nëse ka me marrë vendim, le të hyjë si pikë e mbledhjes...

Arianit Elshani, tha se lidhur me kërkesën për raportimin dhe pikat, të raportoj kryeshefi për planin e punës, periudhat. Njëherit, kërkesat duhet të reflektojnë edhe në rregulloret e KQZ-së sepse, edhe më

herët kam shprehur pakënaqësinë në mënyrën se si vinë çështjet në këshillat e KQZ-së lidhur me disa çështje që i takojnë sekretariatit për tu raportuar; Njëherit, jam dakord që një raportim hyrës ta bëjë, dhe pastaj të shpaloset nga kryeshefit mbi realizimin e planit të punës. Po ashtu, e kam një kërkesë, kam dy njoftime nga aktivitetet e KQZ-së “në të ndryshme”...

Në vazhdim u miratua agjenda e mbledhjes me vota unanime, si dhe po ashtu, u miratuan edhe procesverbalet e mbledhjes së KQZ-së nr. 28 dhe 29/2023 me një abstenim (Gordana Llaban).

2. Aktivitetet e Zyrës

Monitorimi i Kuvendit Zgjedhor të partisë politike SRPSKA LISTA”:

Besnik Buzhala, drejtor i zyrës së partive tha se në raport janë përmbledhur aktivitetet nga data 24 tetor, deri më datën 11 nëntor 2023, që janë: më 24 tetor, zyra ka monitoruar kuvendin e partisë politike “Serbska Lista”, dhe ky kuvend është mbajtur në Mitrovicën e veriut. Në këtë kuvend, 29 anëtarë të Kuvendit me votim të fshehtë kanë zgjedhur kryetarin e partisë, anëtarët e kryesisë dhe nënkryetarin. Më 30 tetor, kjo parti ka sjellë dokumentacionin e këtij kuvendi dhe ne konstatojmë se zgjedhjet në këtë subjekt, janë në përputhje me rregulloren e punës.

Gjithashtu, zyra ka zhvilluar aktivitet edhe me organizata të huaja, si me zëvendës presidentin e International Republican Institute (IRI) në kërkim të bashkëpunimit dhe nxitjen e aktiviteteve të ndryshme. Kemi zhvilluar edhe takim me komisioni e mediave, si dhe kemi pranuar edhe raportet përfundimtare të rregullta të vitit 2021, ashtu si edhe raport e dy palë zgjedhjeve të këtij viti.

Sami Kurteshi, pyeti se mbi bazë të vëzhgimit të kuvendit të subjektit “lista serbska”, duke qenë se unë e kam lexuar edhe statutin e kësaj partie ku flitet për përgjegjësitë, a ka ndonjë masë meqë siç e dimë, së paku një anëtarë i kësaj partie ka marrë pjesë në aktivitete terroriste. A ka ndonjë masë, ndonjë masë...? Çështja tjetër, është se kryetari i partisë thotë se zgjidhet me votim të fshehtë, dhe se kuvendi mund të vendos se zgjedhja mund të bëhet me votim të hapur, gjithnjë sipas statutit....A kishte ndonjë votim, se nuk e pash në raport...?

Çështja e tretë: kërkohet një propozim me shkrim për zgjedhjen e kryetarit të partisë: a ka pasur, paraprakisht propozim me shkrim...?

Besnik Buzhala: Ka pasur shumë gazetarë, dhe ne kemi qenë në fund të hapësirës ku është mbajtur kuvendi, mirëpo procedura që është ndjekur është në përputhje me rregulloren e zyrës. E fundit, propozimi me shkrim, nuk është se ne e kemi vërejtur, po edhe në shkresat që na janë sjellë nuk kemi shkresë – propozim...

3. Raportet e Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Operacione Zgjedhore

Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të Realizimit të Planit të Punës së KQZ-së, për periudhën Janar – Shtator:

Arianit Elshani tha se, KQZ shqyrtuar raportin e planit të punës janar – shtator, ku shpërfaqet puna jonë. Nga kjo, prej 59 aktiviteteve, 21 janë të realizuar dhe 6 janë në procese të realizimit. Por, 29 të tjera, vazhdojnë në këtë vit...

Burim Ahmetaj, tha se sekretariati e ka përgatitur raportin. Ua kemi dërguar raportin. Siç u tha, nga 59 aktivitete, edhe 29 janë në implementim e sipër, dhe 3 janë që do të realizohen në dhjetor, siç është plani strategjik i autidimit të brendshëm, plani preliminar i prokurimit të cilin obligohemi ta bëjmë 30 ditë para përfundimit të vitit fiskal, dhe hartimi i planit të punës së KQZ së për vitin 24. Ne, po punojmë rreth këtij plani...

Në vazhdim, z. Ahmetaj raportoi në detaje mbi realizimi e planit me të dhëna dhe shifra, rreth realizimit të planit të punës janar – shtator 2023. Në fund, ai tha se janë edhe plotësim – ndryshimi i rregullave të brendshme. Dhe ky, është një detyrim zyrtar – i obligueshëm...

Alban Krasniqi: (nuk ka incizim të fillimshëm...), përjashtim, bëjnë vetëm rastet kur KQZ e autorizon kryeshefin që të bëjë nënshkrim. Me këtë rast, ne kemi shkelje edhe të ligjit për zgjedhje, edhe të rregullores ... Unë, po parqes fakte që duhet me kanë pjesë e planit, por që nuk janë paraqitur. Po e përmendi: marrëveshja mes KQZ-së, ky e përfaqëson z. Burim Ahmetaj, dhe Faruk Rexha, zëvendëskryesues i KPM-së, KPM-së. Kanë bërë marrëveshje edhe për bartje të stafit, është bërë aktivitet që nuk është tregue...është shkelje rregullorja; marrëveshja është bërë ta themi, për shkëmbim të stafit, e as Këshilli për Personel dhe as KQZ nuk është njoftuar...

Nuk jemi konsultuar, nuk ka miratim nga KQZ...! Ta zëmë, ne kemi zyrtar që vijnë nga institucionet tjera që i kanë futur duart në buxhetin dhe financat e KQZ-së, për më tepër së fundi, e kemi një zyrtar komunal që një vit e ka punë provuese, dhe ai nuk guxon me u vendosë në pozicione tjera...Qe, ku i kam marrëveshjet e bashkëpunimit, janë edhe dy zyrtarë, madje që janë vendosur edhe në panele për pranimin e një zyrtarin tjetër...Veç të paligjshme, janë edhe cenim i integritetit tonë...

Çështje tjetër që nuk është raport, është vazhdimi i pagesës dhe i beneficioneve tjera për z. Xhemajl Peqani...pra, nuk ka një vendim rreth tij sipas ligjit të ri. Në një mënyrë ligji ja ka ndërpre marrëdhënien e punës...Kjo, është edhe në kundërshtim me ligjin për zgjedhjet, por edhe me ligjin për financat...Kur një personi i ndërprehet puna, ai më s'mund të ketë asnjë lloj beneficioni...Nuk po flas për aspektin human, por zyrtar. Çështja tjetër: çka ndodh në zyrën e personelit...?

Ta zëmë, kur përfundon procesi i zgjedhor ndërprehen edhe kontratat e zyrtarëve jo permanent, por ne kemi një zyrtar që vazhdon ende me punue, dhe kjo kontratë është në kundërshtim me ligjin, sepse procesi është certifikuar. A ka pasur kërkesë për një zyrtarë për shërbime të veçanta, a është shpallur konkurs...? Nuk ka, nuk ka pasur... Dhe ky zyrtar, ka në dorë lloj – lloj dokumente të ndjeshme, madje edhe dokumente financiare, administrative të institucionit tonë! Pesë janë kërkuar, për 19 ditë janë bërë kontratat për në Depo, nuk është shpallë konkursi për marrëveshje të veçanta. I keni marrë...! Plani i rekrutimit nuk është prezentue. Tetë zyrtarë është dashur mu marrë, e nuk na treguet asgjë. A e kuptoni deri ku kemi mbërri...?

Deklarimet e rrejshme përmes avokatit tuaj, si kjo për ju z. Ahmetaj. Keni thënë se ne kemi bërë vlerësim! Procedurë zyrtare për ju, për performancën e juaj nuk kemi ba. Andaj, edhe nuk ka raport. Në shkresën e avokatit, kjo është thënje e pa vërtetë. Thuhet diçka që s'ka ndodh.

Procedurat e rekrutimit...? Të gjitha i kanë kaluar afatet e mundshme. Auditori e ka ba një raport, dhe në bazë të proceduarve të auditimit dhe rekomandimet e tij, ju është dashur me u marrë për bazë. Ju si keni marr, mirëpo e keni obligim ligjor. Shkelen procedurat. KMSHKC-ja, i ka kthye, u ka prish, i ka anulue sepse vendimet tuaja kanë qenë në kundërshtim me ligjin.

Edhe sot kur flasim, ne kemi procese të pa mbyllura, ankesa të aplikantëve etj. Janë një numër çështjesh...! Nuk jam duke folur për emra, njerëz por për procedura. Pastaj, problemet me bashkëpunimit me institucionin e Antikorrupsionit... ?

Dy muaj më parë, kemi marrë imell që të formohet një komision që ka të bëjë me integritetin e institucionit. Na janë fshehur informacionet, kontaktet... Ka tendencë që barrën e përgjegjësive,

mungesën e profesionalizimit është me e bartë te ne, me u marrë ne si KQZ me çështjet...! Kjo ishte edhe kërkesa ime që, me u raportue nga menaxhmenti i sekretariatit...

Keq menaxhimin, nuk po e merr askush. Pastaj, kur jemi te pasuria “jo financiare”! Raporti është voluminoz, kam me i kërkuë të prezantohen të gjeturat, është një pasuri rreth 50 mijë euro e cila nuk është e regjistruar e kujt është, si është...! Ka edhe pasuri të tjera që janë të zhvleftësuar por nuk ka parametra qysh janë zhvillua procedurat. Ne, mund të rrëshqasim në një gjendje konfuze, ku ne pa dijen tonë marrim vendim mbi astetet që u ka humbur vlera, mirëpo procedurat nuk janë zhvilluar si duhet.

Adresimi i ligjeve në raport, është i pjesshëm. Si zbatohet ligji, çka merret, çka nuk merret, si merren vendime, mbi cilin ligj, a respektohet ligji i ri apo i vjetër, cilat janë procedurat...?

Këto që i thash, nuk janë veç shkelje administrative, por edhe penale! Ne, duhet të sqarojmë veten, dhe propozoj me u themelue një komision, ashtu si e parasheh ligji për zyrtarët publik, pra një komision disiplinorë që, pretendimet si këto që i ngrita, dhe të tjerat me u trajtue nga ai “komision disiplinorë”...

Unë, nuk dua ta marrë rolin e prokurorit, të gjyqtarit...! Dikush duhet të marrë përgjegjësi...Në mbledhjen e radhës, kërkoj të formohet ky komision. Pra, ne duhet të sigurohemi që ligjshmëria zbatohet, plani i punës nuk është i pjesshëm etj.

Nuk po dua me u lodh, për shembull, e kam një fakturë rryme të KKZ të Vushtrrisë, vjen me u pague, e pyetja është: a, kemi marrëveshje – vendim që ajo zyre është nda për KQZ, dhe ne e kemi një zyre që figuron në asetet tona dhe ne duhet të paguajmë rrymë ? Sa lehtë i japim parat...? Edhe komisioni i ankesave, a ka bazë që duhet me funksionue ? Ligji i ri nuk parasheh më formim të komisioneve...Nuk ka kësi komisioni, shkon direkt të KPMSHKC-ja. Nëse është ndryshe, le të na thonë por, unë ligjin e kam lexue...! Zero, tash është vlere e atij komisioni, është i jashtëligjshëm...

Ka edhe raste të tjera...

Kreshnik Radoniqi: Dy çështje: një është realizimi i planit të punës, dhe raportimi i Arianitit dhe Burimi. Tani, është edhe kjo çështje rreth formimit të një komisioni! Kjo çështje, duhet të shihet me ligj, me rregullore të brendshme. Nuk mund të formojmë komision, pa pas diçka konkrete, një kërkesë, një “dosje” ndoshta duhet me u bë...Por, edhe njëherë rreth planit të punës...

A ka dikush diçka...?

Arianit Elshani: Sa i përket planit, janë diku 8 aktivitete të cilat, ishte dashtë të përfundohen por, shumica e këtyre varen nga vet KQZ: për shembull “udhëzimet administrative”, “rregullat zgjedhore”, rregullorja për QNR, dhe disa aktivitete tjera...Pra, ende janë sfiduese, dhe po dua të kërkoj që të jemi më azhur në trajtimin e këtyre aktiviteteve...

Mendoj që ka këndvështrime të ndryshme. Ne duhet ti shohim gjërat konkretisht, ligjërisht sepse “çështjet humane” janë tjera, dhe duhet të marrim masa, ato që duhet dhe mund të merren sepse, nuk është se kemi borgj ndaj dikujt.

Janë edhe çështjet tjera të cilat i ngriti Albani, si çështja e z. Peqani ! Ne, pavarësisht kush çka mendon, ne e kemi ligjin për zgjedhjet e përgjithshme, e për shumë gjëra ku jemi ne ? Po konsideroj që duhet të ecim më shpejtë...

Mufera Sinik: KDTP ka mbajtur mbledhjen më 5 nëntor, por nuk ka pas zyrtar që kanë marrë pjesë në mbledhje. Pse nuk ka pas nuk e di, por tjetër herë duhet me pas...

Besnik Buzhala, tha se, ne e kemi pasur njoftimin por, për shkak të çështjeve audituese kemi harrue me e përcjellë. Në emër të zyrës, ju kërkoj falje...

Alban Krasniqi: Unë, fola për aktivitete që janë krye por që nuk janë paraqitur në raport. Unë, nuk pajtohem me Arianitin, por nuk janë përgjegjës të tona. Janë çështje profesionale të Sekretariatit, janë departamentet...! Si me thanë, është disi heqje dorë nga përgjegjësitë: hajt se ka kush merret... Nuk janë përgjegjësi tona, madje as rregulloret...Ose, 4 konkurse që prej marsit, nuk janë përmbyllë...

Arianit Elshani: Po du me i theksue çështjet: sot, nuk kemi drejtor të administratës, drejtor të zgjedhur, nuk ka udhëheqës të prokurimit, drejtor të shërbimit votues, nuk ka zyrtarë të lartë në katër komuna, nuk ka zyrtar të lartë në Gjilan për shkak të pensionimit, nuk ka udhëheqës të QNR-së....Nesër me hy në zgjedhje, unë nuk e di me cilën bazë ligjore, të rregullave, procedurave, manualeve etj., nuk di si kishim me mbajte zgjedhje...?

Ilir Gashi: Po dalim jashtë teme nganjëherë: ne po flasim për një plan që është i përbashkët. Ne, pikat e këtij plani i kemi votue. Nuk po debatojmë për punën e kryeshefit, të sekretariatit. Ne, i kemi vendos shtyllat e këtij plani, dhe e kemi raportin. Mendimet tona, duhet ti japim mbi bazë të asaj se, çka a zbatue e çka jo...Shpresoj që përfundojnë ato që i kemi planifikue, që ende nuk janë realizue...

Në këtë pikë, diskutuan edhe më tej: Alban Krasniqi, Arianit Elshani, Kreshnik Radoniqi.

Në fund, raporti u votua me 8 vota për, 2 kundër dhe 1 abstenim u miratua raporti i realizimit të Planit të Punës së KQZ-së për periudhën: Janar – Shtator 2023.

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për projektin “Informimi dhe Edukimi i Votuesve të Rinj për Zgjedhje”:

Arianit Elshani, tha se KOZ e ka shqyrtuar projektin për Informimin dhe Edukimin e Votuesve të Rinj për Zgjedhje”. Shpallja tenderuese e këtij projekti ka dështua, dhe ne kemi kërkuar që të vazhdohet me procedura. _Për shkak të këtyre ngecjeve, ne kemi propozuar që ky aktivitet të vazhdohet në tremujorin e parë të vitit të ri. Tash, ju po kërkonim që procedurat e tenderimit të vazhdojnë, mirëpo buxhetin e këtij viti ne s’mund ta bartim në vitin e ardhshëm...

Pra, janë dy çështje të ndara...!

Sami Hamiti: A është tenderue, nëse jo, s’mund të realizohet. Pra, edhe me kohë s’mund të tenderohet, pra nuk mund të shpenzohet, logjikisht të realizohet, sepse viti fiskal mbyllet 24-25 në dhjetor...

Në këtë pikë, diskutuan më tej: Alban Krasniqi dhe Arianit Elshani.

Shqyrtimi dhe miratimi i Analizës gjinore dhe e moshës e lidërshipt të partive politike për periudhën 2022-2023:

Arianit Elshani, tha se KOZ ka shqyrtuar një analizë nga zyra e partive politike mbi grupmoshat dhe gjinitë e organeve më të larta të subjekteve politike. Nga kjo analizë, dalin të dhënat se, për shembull në vitin 2022, nga 44 parti politike, 77.26% e organeve drejtuese të këtyre partive kanë në përbërje meshkuj, dhe vetëm 22.73% në përbërje femra.

Në këtë vit, 2023, kemi një rritje të pjesëmarrjes së gjinisë femra: nga “77.26” ka një rënie në rreth “ 2 %”, pra, kuota e pjesëmarrjes së femrave ngjitet në rreth 24%.

Sa u përket kryetarëve të partive politike, nga 44 parti në vitin 2022, prej tyre 94% janë burra, dhe vetëm 9.53 % femra.

Në vitin 2023, kemi 1 kryetar femër më shumë. Nuk po flas më shumë, e keni pasur raportin dhe besoj se, kjo është...

Në këtë pikë, diskutuan: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Fazli Stollaj, Besnik Buzhala, drejtor i zyrës së partive. Raporti u vlerësua si i mirë dhe me të dhëna e shifra të rëndësishme, sidomos që mund të ju shërbej subjekteve politike.

Në fund, raporti në mënyrë unanimiti, u miratua.

Këshilli për Buxhet dhe Financa

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit Financiar për periudhën janar-shtator 2023:

Gordana Llaban: Në këtë periudhë, kemi pasur dy takime. Në këto takime, kemi shqyrtuar raportin financiar për periudhën janar-shtator 2023, kemi shqyrtuar edhe raportin e derivateve për periudhën janar-shtator 2023, si dhe pika e tretë ka qenë raporti i kontratave të nënshkruara për periudhën janar – shtator 2023.

Raporti financiar, është kështu: KQZ bazuar në ligj, ka pasur një buxhet prej 6 milion e 387, 740 euro për të zhvilluar detyrat dhe obligimet e veta. Në vazhdim, znj. Llaban, paraqiti me shifra buxhetin e shpenzuar në këtë periudhë për shërbime komunale dhe për mallra e shërbime të KQZ-së. Të dhënat e detajuara, janë edhe në raport...

Lidhur me këtë raport, në fakt mbi pasqyrat financiare, diskutoi z. Sami Hamiti që bëri një zbërthimin të çështjeve të buxhetit, shpenzimet, uljen, nivelimin e tyre etj. Në fund, ai e cilësoi raportin kompakt dhe në raport të plotë me ligjin për financa publike.

Alban Krasniqi, tha se këto raporte, kam kërkuar që të paraqiten në formë tabelare – grafike sepse, të gjithë e kuptojmë më lehtë. Po, tani më intereson se si shfrytëzohet buxheti, a kanë qenë të planifikuara shërbimet e veçanta, si janë paguar disa shërbime, disa zyrtarë, disa çështjet e prokurimit, cilat procedura janë përdorur etj.

Kreshnik Radoniqi, tha se, të dhënat janë të sakta, të detajuara...

Në fund, u miratua raporti financiar për periudhën janar-shtator 2023.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të derivateve për periudhën janar-shtator 2023:

Gordana Llaban: KQZ ka 12 automobila në përdorim, dhe gjatë kësaj periudhe, janë shpenzuar mbi 11 e 800 litra derivate. Në vazhdim, znj. Llaban, raportoi edhe mbi atë se sa kilometra janë kaluar.

Me 8 vota për, u miratua ky raport.

3. Raporti i kontratave të nënshkuara për periudhën janar – shtator 2023:

Gordana Llaban: (nuk ka incizim...)

Alban Krasniqi, tha se raporti i punës, i buxhetit dhe i prokurimit janë obligime të personave përgjegjës. Pra, raportin duhet ta paraqes përgjegjësi, sepse ai i njeh më mirë rrethanat, sfidat etj.

Haki Krasniqi, ushtrues i detyrës së Drejtorit të Prokurimit, raportoi mbi disa aktivitete, sfidat që kanë ndodhur, dhe për disa aktivitete që nuk janë kryer. Në fillim të dhjetorit, do të bëjmë një raport të detajuar lidhur me prokurimin, njësitë, tenderimet etj.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit për pasuri jo financiare të KQZ-së:

Burim Ahmetaj, raportoi lidhur me këtë pikë dhe tha se, situata është e njëjtë. Asnjë pasuri s'është tjetërsuar veç "tabletëve" që janë dhuruar. Nuk janë fshi ende nga sistemi, dhe figuron ende si "gjetje" e raportit... Regjistri i tërë i inventarit, ka mos përputhje ! Veturat e KQZ-së për shembull, nuk janë të përfshira në këtë regjistër...Komisioni i ardhshëm, duhet që saktë t'i shqyrtoj çështjet me inventatizimin... Ky proces, nuk është i lehtë, duhet të kemi standarde në këtë proces...

Alban Krasniqi, tha se dua ta di se, unë kam vërejtur "dy raporte" të komisionit, me "dy shenja të protokollit". Kur është bërë ky raport, dhe a ndryshon prej të parit. Si është gjendja, kush e ka kryesuar, si është hartuar...?

Kam nevojë me ditë se, a kanë ngjashmëri raportet njëri me tjetrin; Po jap disa vlerësime, raporti nuk e përmend rregulloren mbi të cilën bëhet regjistrimi i pasurisë...Ju lutem, vendoseni rregulloren në ueb faqen e KQZ-së. Raporti i auditorit gjeneral, e përmendë menaxhimin e pasurisë jo financiare. Regjistri, ka të dhëna të vjetra...Ka ende pasuri nën "emra dhe mbiemra" që, nuk janë më në KQZ, nuk punojnë më në

KQZ...! Numri i pajisjeve të paregjistruara, është 190: laptop, pajisje të IT, karrike, tavoliana etj. Pajisje këto që nuk janë fare të regjistruara, e raporti thotë se pasuria e këtillë shkon deri në 50 mijë euro...

Nuk kemi raporte të sakta të pasurisë së KQZ: si është ble, sa na janë falë etj. Numri i pajisjeve pa “bar kod”, është: 3, 155. Prej këtyre, i kemi në shfrytëzim: 2451. Këto, janë pa bar kod! Një raport është kryer në qershor, mirëpo nuk kemi pasur të dhëna që prej atëherë dhe, tash na është sjellë një raport që na kërkohet me e aprovua...! Tash si me aprovua, kur mendoj se gjendja faktike e tij, tashmë ka ndryshua...

Burim Ahmetaj, tha se raporti është shqyrtua në menaxhment, pastaj në këshillin për buxhet dhe financa, nuk më kujtohet saktë muaji....Ajo që është heqë, ka qenë e njëjtë edhe në raportin paraprak të vitit të kaluar, dhe menaxhmenti ka konsiderua se ajo pjesë nuk duhet me u pasqyrua sepse është në proces të asgjësimit si pasuri jo financiare...Nuk kemi arritur me e ba ende shpalljen e aktivitetit të prokurimit të ankandit publik. Rekomandimi ka qenë që këto materiale të asgjësohen; rekomandim tjetër nuk ka pas veçse, asgjësim ose tjetërsim përmes ankandit publikë...

Në fund, raporti u miratua ky raport.

Njoftim nga Komiteti i Auditimit

Sami Kurteshi, kryesues i Auditimit të Brendshëm tha se, kemi shqyrtuar dy pika të rregullta, dhe tjerat të ndryshme. Një, kemi shqyrtuar dikustimin e raportit të parë të vlerësimit: “Pasqyrat vjetore financiare 2022”. Konstatimi është se, kualifikimi për një institucion të vogël si ky, nuk duket mirë ! Është propozue me u krijua një grup prej tre vetash që t’ketë raport prej tyre për çdo tre muaj. Komiteti i propozon KQZ-së.

Kemi diskutua edhe raportin final të raportit të auditimit – performancën e aktivitetit të trajnimit. Ne, e kemi diskutuar gjerë e gjatë, është raport i mirë, janë të dhënat, krahasimet etj. Çështja e trajnimit, si konstatim, duhet të shqyrtohet më gjatë nga KQZ sepse, janë nevoja specifike...

Lidhur me “Listën e rreziqeve” po ashtu, ne kemi diskutua. E kemi listën por, se kemi një koordinator të kësaj liste që, i raporton udhëheqësit kryesorë. Pra, ky person luan rolin e sinjalizuesit mbi çështje të ndryshme...

Gjithashtu, kemi diskutuar edhe çështje tjera, si miratimi i ndryshimit të statutit për kompensimin e anëtarëve të komitetit... Ne, do t'ua dërgojmë dokumentacionin.... Në rastin tjetër, ka një aktivitet që ka mbetur dhe që pa marrë KQZ vendim nuk mundet me u realizua...

Këto janë si njoftim, por edhe si rekomandim nga mbledhja që kemi pasur.

Alban Krasniqi: le të përfillen procedurat nga auditori. Por, ne për propozimet duam të kemi procedura, si bëhet kjo, si realizohen këto rekomandime. Pra, jo vetëm përmes imellave...

Syleman Gashi, auditor i brendshëm, tha se këto çështje – rekomandime nuk janë pjesë e ligjit, por janë praktika të mira që vijnë nga institucionet e jashtme. Ai, shpjegoi rëndësinë e formimit të këtyre komisioneve, rritjen e mbikëqyrjes, operacionalizimin më efikas të detyrave dhe përgjegjësive etj.

Në këtë pikë, diskutuan edhe Sami Hamiti, Kreshnik Radoniqi, Alban Krasniqi, Kreshnik Radoniqi, Sylejman Gashi, Sami Kurteshi.

6. Të ndryshme !